



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/50

Datë: 23.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti nga mbledhja e 44 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/50
Datë: 23.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Analiza juridike për vlerësimin e bazës ligjore të akteve nënligjore të nxjerra nga ministrat.
2. Shfuqizohen aktet nënligjore, si në vijim:
 - 2.1 Udhëzim Administrativ (MM) Nr. 01/2020 për Mirëmbajtje Logjistike në Forcën e Sigurisë së Kosovës;
 - 2.2 Rregullore (MM) Nr. 09/2019 për Planifikimin në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës;
 - 2.3 Udhëzim Administrativ (MM) Nr. 03/2020 për Arsimim dhe Stërvitje;
 - 2.4 Rregullore Nr. 11/2017 për Punën e Depos së Mallrave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 2.5 Udhëzim Administrativ Nr.02/2014 për Ofrimin dhe Sigurimin e Përkrahjes Financiare të OJQ-ve Vendore gjatë vitit 2014;
 - 2.6 Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2013 për Mbajtjen e Evidencave të Posaçme për Vendet e Lira të Punës për Shtetasit e Huaj dhe Shtetasit Kosovar të cilët me Ndërmjetësimin e Zyrave të Punësimin punojnë jashtë vendit;
 - 2.7 Udhëzimi Administrativ Nr.09/2011 për Procedurat e Themelimit dhe Menaxhimit Financiar të Fondit të Aftësimeve Profesionale;
 - 2.8 Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2010 për Procedurat e Lajmërimit të Shfrytëzuesve të Pensioneve të Skemës Pensionale të Përcaktuara me Ligjin Nr. 02/L-2;
 - 2.9 Udhëzimi Administrativ Nr.14/2012 për Ndryshimin dhe Plotësimin e UA Nr.05/2010 për Rregullimin e Dhënies së Lejeve për Punë dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës;

- 2.10 Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.08/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2009 për Themelimin, Organizimin dhe Funksonimin e Zyrës së Komisioneve Mjekësore;
- 2.11 Udhëzimi Administrativ Nr.18/2009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e UA Nr.07/2009 për Organizimin, Funksonimin dhe Fushëveprimin e Qendrave për Aftësim Profesional në Republikën e Kosovës;
- 2.12 Rregullore Nr.09/2008 mbi Organizimin e Brendshëm të Punës në Shtëpi për Personat e Moshuar dhe pa Përkrahje Familjare;
- 2.13 Udhëzim Administrativ Nr.04/2007 për Rregullat dhe Procedurat për Përkrahjen Financiare të Rezidentëve të Strehuar në Shtëpitë e Personave për Përkujdesje Sociale;
- 2.14 Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2010 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2006 për Punën e Komisionit Mjekësor lidhur me Vlerësimin dhe Caktimin e Shkallës së Invaliditetit të Invalidëve të Luftës;
- 2.15 Udhëzimi Administrativ Nr.01/2005 për Fushëveprimin dhe Përgjegjësitë e Njësisë së Kontrollit të Pavarur të Skemave të Mirëqenies Sociale të MPMS;
- 2.16 Udhëzim Administrativ Nr.05/2005 për Ndarjen e Mjeteve Financiare Rezidentëve të Vendosur në Institucionet e MPMS;
- 2.17 Udhëzimi Administrativ Nr.14/2004 për Angazhimin e Ekspertëve Mjekësor në Komisionet Mjekësore të MMPS;
- 2.18 Udhëzim Administrativ Nr.08/2009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e UA Nr. 17/2004 për Themelimin dhe Fushëveprimin e Departamentit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe Personat e Tjerë që kontribuon në Luftën e UÇK-së;
- 2.19 Udhëzimi Administrativ Nr.09/2009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e UA 06/2003 për Themelimin e Departamentit të Administratës Pensionale;
- 2.20 Udhëzimi Administrativ Nr.01/2013 për Ofrimin dhe Sigurimin e Përkrahjes Financiare të OJQ-ve Vendore gjatë vitit 2013;
- 2.21 Udhëzim Administrativ (MTI) Nr.11/2014 për Kushtet për Subjektet që kryejnë Procedurat e Vlerësimit të Konformitetit për Produktet e Ndërtimit;
- 2.22 Rregullore (MTI) Nr. 06/2014 për Mënyrën e Vlerësimit të Konformitetit për Produktet Ndërtimore;
- 2.23 Rregullore (MTI) Nr. 05/2014 për Përcaktimin e Çmimeve dhe Shitjen e Mallrave me Zbritje;
- 2.24 Rregullore (MTI) Nr.02/2014 për Kërkesat Themelore në Punët e Ndërtimit
- 2.25 Rregullore (MTI) -Nr. 09/2013 për Etiketimin, Prezantimin dhe Reklamimin e Produkteve Ushqimore;

- 2.26 Rregullore (MTI) - Nr. 07/2013 për Miratimet Teknike për Produktet e Ndërtimit;
- 2.27 Udhëzim Administrativ Nr. 13/2011 për Monitorimin e Produkteve Ndërtimore;
- 2.28 Udhëzim Administrativ Nr. 2008/22 Betoni dhe Konstruksionet e Betonit;
- 2.29 Udhëzim Administrativ Nr. 2008/14 për Themelimin e Këshillit Konsultativ;
- 2.30 Udhëzim Administrativ Nr. 2008/06 për Shenjat e Prodhuesit, Punuesit dhe Shitësve të Punimeve nga Metalet e Çmuara;
- 2.31 Udhëzim Administrativ Nr. 2007/07 për Kërkesat Teknike dhe Vlerësimi i Konformitetit për Dyer dhe Dritare;
- 2.32 Udhëzim Administrativ Nr. 2007/02 Çimentoja për Konstruksione Betoni;
- 2.33 Udhëzim Administrativ Nr. 2006/29 për Formën dhe Përmbajtjen e Dokumentit-Autorizimit me të cilin Lejohet Vlerësimi i Konformitetit të Produkteve Ndërtimore;
- 2.34 Rregullore Nr.02/2014 për Planifikimin e Personelit të Shërbimit Civil;
- 2.35 Rregullorja Nr. 02/2012 mbi Themelimin dhe Funkcionimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të OJQ-ve;
- 2.36 Rregullore Nr.03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civil;
- 2.37 Udhëzimi Administrativ Nr.01/2010 mbi Sigurinë dhe Qasjen në Bazën e të Dhënave;
- 2.38 Udhëzimi Administrativ Nr.02/2010 për Menaxhimin e Sigurisë së Informatave;
- 2.39 Rregullore Nr.01/2010 për Rendin Shtëpiak në Ish Ndërtesën e Pallatit të Rilindjes;
- 2.40 Rregullore Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil;
- 2.41 Rregullore Nr.03/2010 për Përshkrimin e Detyrave të Punës;
- 2.42 Udhëzim Administrativ Nr.01/2009 për Tarifat e Produkteve dhe Shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës;
- 2.43 Udhëzim Administrativ Nr.02/2009 për Shërbimet e Transferimit të Pagës së Anëtarësisë Sindikale;
- 2.44 Udhëzimi Administrativ Nr.02/2008 për Regjistrimin e Dhuratave në Institucionet e Shërbimit Civil të Kosovës;
- 2.45 Udhëzimi Administrativ Nr.03/2008 për Mbishkrime në Ndërtesa të Institucioneve Qeveritare të Republikës së Kosovës;

- 2.46 Udhëzimi Administrativ Nr.04/2008 për Veshjen dhe Paraqitjen e Nëpunësve Civil;
- 2.47 Udhëzimi Administrativ Nr.05/2008 për Forumin e Menaxherëve të Personelit;
- 2.48 Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2007 për Regjistrimin e Masave Disiplinore;
- 2.49 Udhëzimi Administrativ Nr.2006/02 për Certifikatën me Aftësi Ligjore për të Lidhur Martesë;
- 2.50 Udhëzim Administrativ Nr.2005/04 për Furnizim me Regjistra të Gjendjes Civile, Regjistra të Shënimeve dhe Certifikata;
- 2.51 Udhëzimi Administrativ Nr.2005/06 për Përdorimin Origjinal të Emrit Personal në Dokumentet Personale dhe Publike;
- 2.52 Udhëzimi Administrativ Nr.2003/12 për Mundësi të Barabarta;
- 2.53 Rregullorja (MeD) - Nr. 1/2017 për Kriteret dhe Mënyrën e Subvencionimit të Projekteve për Diasporën;
- 2.54 Udhëzim Administrativ (MeD) Nr.01 /2014 për Regjistrimin dhe Mirëmbajtjen e Pasurisë në Qendrat Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën;
- 2.55 Udhëzim Administrativ Nr. 2008/3 për Mbikëqyrjen, Pranimin Teknik dhe Kolaudimin e Punëve të Kryera në Infrastrukturën Rrugore;
- 2.56 Udhëzimi Administrativ Nr. 2006/12 për Leje të Posaçme, Transite dhe Bilaterale në Transportin Rrugor Të Mallrave;
- 2.57 Udhëzim Administrativ MMPH- Nr. 05 /2018 për Përmbajtjen dhe Mënyrën e Dhënies së Provimit Profesional për Mbikëqyrësit e Zonave të Mbrojtura;
- 2.58 Udhëzim Administrativ MMPH - Nr.03/2016 për Caktimin e Tarifave për Lëshimin e Pëlqimeve, Lejeve, Licencave, Certifikatave dhe Vërtetimeve të Parapara me Legjislacionin për Mbrojtjen e Natyrës;
- 2.59 Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr.01 /2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 03/2016 për Caktimin e Tarifave për Lëshimin e Pëlqimeve, Lejeve, Licencave, Certifikatave dhe Vërtetimeve të Parapara me Legjislacionin për Mbrojtjen e Natyrës;
- 2.60 Udhëzim Administrativ MMPH - Nr.02/2015 për Lejimin e Zbatimit të Hulumtimeve Shkencore në Natyrë;
- 2.61 Udhëzim Administrativ Nr. 04/2009 për Kontrollin e Emisioneve të Bashdijimeve Organike të Avullueshme gjatë Deponimit, Zbrazjes, Mbushjes dhe Transportimit të Karburanteve;
- 2.62 Udhëzim Administrativ MMPH-Nr. 09/2015 për Lejen për Vendosjen në Treg, Regjistrim dhe Leje Importi të Produkteve Biocide;

- 2.63 Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 18/2015 për Regjistrimin e Shpronësimit të Pronës së Paluajtshme;
- 2.64 Udhëzim Administrativ Nr. 58/2005 për Mbajtjen e Evidencës së Inspektimit- Forma e Regjistrimit, Formulari që përdoret gjatë inspektimit;
- 2.65 Udhëzim Administrativ Nr. 59/2005 mbi Mënyrën e Kryerjes së Mbikëqyrjes Inspektive të Inspektionit Ndërtimorë;
- 2.66 Udhëzim Administrativ Nr. 60/2005 për Mbylljen e Vendndërtimit dhe Mënyrën e Rrethimit të tij nga Inspektorati Ndërtimor;
- 2.67 Udhëzim Administrativ Nr. 14/2010 për Caktimin e Objekteve me rëndësi për vendin për të cilat Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lëshon lejen urbanistike;
- 2.68 Rregullore Nr. 04/2011 për mënyrën e llogaritjes së pagesës për Kontrollin Teknik të Objekteve Ndërtimore;
- 2.69 Rregullore Teknike Nr. 03/2009 për Kursimin e Energjisë Termike dhe Mbrojtjen Termike në Ndërtesa;
- 2.70 Udhëzim Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- 2.71 Udhëzim Administrativ Nr. 37/07 për Administrimin e Bifenileve dhe Trefenileve të Polikloruara;
- 2.72 Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 11/2014 për Themelimin, Zgjedhjen, Përgjegjësitë dhe Funksonimin e Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe;
- 2.73 Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 12/2014 për Themelimin, Zgjedhjen, Përgjegjësitë dhe Funksonimin e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit dhe të Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit;
- 2.74 Udhëzim Administrativ Nr. 21/2021 për Notifikimin e Substancave të Reja;
- 2.75 Udhëzim Administrativ Nr. 70/2006 për Kontrollimin e Projekteve;
- 2.76 Udhëzim Administrativ Nr. 57/2005 për Kushtet e Kualifikimit për Inspektor Ndërtimor të MMPH-së dhe Inspektor Ndërtimor Komunal;
- 2.77 Udhëzim Administrativ Nr. 32/07 për Përmbajtjen e Infrastrukturës Ujore;
- 2.78 Udhëzim Administrativ Nr. 64/2005 për Nostrifikimin e Projektit;
- 2.79 Udhëzim Administrativ Nr. 67/2005 për Kushtet dhe Masat e dhënies së Autorizimit për Kontrollin e Projekteve;
- 2.80 Udhëzim Administrativ Nr. 68/2005 për Inspektimin Teknik të Objekteve Ndërtimore;
- 2.81 Udhëzim Administrativ Nr.03/2013 për Këshillin Zbatues dhe Monitorues;

- 2.82 Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrin të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme;
- 2.83 Udhëzim Administrativ-Nr.03/2011 për Formën, Përmbajtjen dhe Mënyrën e Plotësimit të Aplikacionit për Leje të Integruar;
- 2.84 Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2011 për Grumbullimin e Llojeve të Bimëve të Egra, të Mbrojtura me Qëllim të Përpunimit dhe Tregtimit;
- 2.85 Rregullore Nr. 01/2015 për Shërbimet e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Dhe Institucioneve të Saja;
- 2.86 Udhëzim Administrativ Nr.04/2009 për Hapjen e Tregut të Energjisë Elektrike për të gjithë Konsumatorët Jo-Familjar;
- 2.87 Urdhëresë Administrative Nr.1/2009, për Autoritetin Rregullativ të Telekomunikacionit për Fillimin e Veprimeve për Krijimin e Regjistrin dhe Menaxherit të Regjistrin për Kryedomenin “.KS” të Kodit Shtetëror për Internet të Republikës së Kosovës – (Ang. Country Code)“;
- 2.88 Rregullore Nr. 01/204 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullore Nr. 04/2011 për Trajtimin e Komunitetit në Sektorin Minerar;
- 2.89 Udhëzim Administrativ Nr. /2008 mbi Enët e Thjeshta nën Presion;
- 2.90 Udhëzimi Administrativ Nr.05/2007 për Caktimin e Kriteve dhe Gjohave Administrative;
- 2.91 Udhëzim Administrativ Nr.2005/4 për Rregullimin e Shërbimeve Universale Postare;
- 2.92 Udhëzimi Administrativ Nr.2004/3 mbi Caktimin e Dënimeve të Kundërvajtjeve nga telekomunikacioni;
- 2.93 Udhëzim Administrativ Nr. 2012/02 për Zbatimin e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës;
- 2.94 Udhëzim Administrativ MBPZHR Nr. 15/2013 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2013 për Masat dhe Kriteret e përkrahjes për Zonat Rurale më pak të Zhvilluara;
- 2.95 Udhëzim Administrativ Nr. 11/2013 për Përcaktimin e Tarifës së Çmimeve për Shërbimet e Kontrollit të Kryera në Laboratorin e Institutin Bujqësor të Kosovës në Pejë;
- 2.96 Udhëzim Administrativ Nr. 14/2012 për Ndryshim dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2012 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2012;
- 2.97 Udhëzim Administrativ Nr. 11/2012 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2012;

- 2.98 Udhëzim Administrativ Nr. 03/2012 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për Vitin 2012;
- 2.99 Udhëzim Administrativ Nr. 06/2012 për Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2012 për Pagesa Direkte në Bujqësi për Vitin 2012;
- 2.100 Udhëzim Administrativ Nr. 01/2012 për Pagesa Direkte në Bujqësi për Vitin 2012;
- 2.101 Udhëzim Administrativ Nr. 16/2011 për Caktimin e Formës dhe Përmbajtjes së të Dhënave në Fitocertifikatën për Eksport, Rieksport dhe Fitocertifikatën për Qarkullim të Brendshëm të Bimëve, Produkteve Bimore Dhe Objekteve tjera;
- 2.102 Udhëzim Administrativ Nr. 10/2011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 19/2005 për Licencimin e Ndërmarrjeve, Ndërmjetësve për Prodhim Tregtim të Ushqimit të Kafshëve dhe Aditivëve;
- 2.103 Udhëzim Administrativ Nr. 13/2011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Ma-Nr.20/2006 Standardet e Cilësisë dhe Kategorizimi i Qumështit të Freskët;
- 2.104 Udhëzim Administrativ Nr. 11/2010 për Regjistrin e Prodhuesve të Bimëve, Përpunuesve, Importuesve, Shpërndarësve, Deponuesve, Paketuesve, Eksportuesve, Shitësve me Shumicë të Bimëve, pjesëve tjera dhe Produkteve Bimore;
- 2.105 Udhëzim Administrativ Nr. 01/2010 për Themelimin dhe Funkcionalizimin e Njësisë së Pagesave;
- 2.106 Udhëzim Administrativ Nr. 30/2008 për Farmakvigjilencën Veterinare;
- 2.107 Udhëzim Administrativ Nr. 25/2008 për Riprodhimin e Kafshëve;
- 2.108 Udhëzim Administrativ Nr. 20/2008 për Krijimin e Regjistrit të Prodhuesve, Importuesve, Eksportuesve, Deponuesve dhe Shpërndarësve të Bimëve, Produkteve Bimore Dhe Objekteve tjera në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- 2.109 Udhëzim Administrativ Nr. 5/2008 për Mbarështimin e Kërmijve dhe Vënien në Qarkullim të Prodhimeve të tyre;
- 2.110 Udhëzim Administrativ Ma-Nr. 29/2007 për Caktimin e Formës dhe Përmbajtjes së të dhënave në Fitocertifikatën për Eksport, Ri-Eksport dhe Fitocertifikatën për Qarkullim të Brendshëm të Bimëve, Produkteve Bimore dhe Objekteve tjera;
- 2.111 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 14/2007 Regjistrimi i Prodhimtarisë për Përcaktimin të Vlerës Gjenetike të Kafshëve Riprodhuese;
- 2.112 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 02/2007 për Plotësim dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MA- Nr. 07/2005 të Dt. 31 Mars 2005 për Caktimin e Kushteve për Licencimin e Subjekteve Afarist që kryejnë Veprimtari të Qarkullimit, Importimit të Produkteve Mjekë;

- 2.113 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 40/2006 për Organizimin e Punës, Kompetencat, Mënyra e Vendosijes së Organeve dhe Komisioneve të Federatës së Shoqatave të Përdoruesve të Ujit;
- 2.114 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 23/2006 për Organizimin e Punës, Kompetencat, Mënyrën e Mbajtjes dhe Vendosijes në Mbledhjet e Organeve të Shoqatave të Përdoruesve të Ujit;
- 2.115 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 22/2006 për Mbajtjen e Librit Amëz të Kafshëve;
- 2.116 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 20/2006 Standardet e Cilësisë dhe Kategorizimi i Qumështit të Freskët;
- 2.117 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 17/2006 për Kontrollin e Cilësisë së Ushqimit të Kafshëve dhe Aditivëve;
- 2.118 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 08/2006 për Themelimin e Komisionit të Përhershëm për Ushqim të Kafshëve;
- 2.119 Udhëzim Administrativ MA - Nr. 07/2006 për Themelimin e Komisionit të Përhershëm për Mbarëshkrimin e Kafshëve;
- 2.120 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 04/2006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MA-Nr.13/05 për Licencimin e Ripaketuesve të Plehrave Artificiale;
- 2.121 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 02/2006 Lëndët e Para të Ushqimeve të Përbëra për Kafshë;
- 2.122 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 28/05 Ushqimet e Përbëra për Kafshë;
- 2.123 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 19/05 për Licencimin e Ndërmarrjeve, Ndërmjetësve për Prodhim, Tregtim të Ushqimit të Kafshëve dhe Aditivëve;
- 2.124 Udhëzim Administrativ MA-Nr.15/2005 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2003 I Dt. 17.12.2003 për Themelimin, Përgjegjësitë, Funkcionet dhe Organizimin e Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- 2.125 Udhëzim Administrativ MA-Nr. 04/2005 për Organizimin dhe Funkcionimin e Qendrës për Mbarëshkrimin e Kafshëve, Certifikimin e Personave dhe Organizatave që ndërmarrin Aktivitete në Mbarëshkrimin e Kafshëve;
- 2.126 Udhëzim Administrativ Nr.9/2004 për Licencimin e Veprimtarive të Industrisë Ushqimore, Jo Ushqimore dhe Ndërtimore dhe Certifikimin e Produkteve të Industrisë Bujqësore;
- 2.127 Udhëzim Administrativ Nr. 04/2004 mbi Ndalimin e Importimit të Pulave të Amortizuara, me Qëllim të Ruajtjes së Shëndetit të Shpezëve dhe Shëndetit të Konsumatorëve;
- 2.128 Udhëzim Administrativ Nr. 02/2012 për Tarifat e Përkohshme Noteriale;

- 2.129 Udhëzim Administrativ Nr.05/2011 për Honorarin e Ndërmjetësuesve;
- 2.130 Udhëzim Administrativ Nr.03/2008 për Menaxhimin Zyrtar të Arkivit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- 2.131 Udhëzim Administrativ Nr.03/2008 Pagesa për punë gjatë Kujdestarisë në Gatishmëri me dalje në terren dhe gjatë natës mbi Kompensimet Stimuluese për punë të veçantë dhe Specifike që kryen stafi Profesional i Zyrës për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore;
- 2.132 Rregullore e Brendshme Nr.01/2013 për Menaxhimin dhe Implementimin e Projekteve Kapitale të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim;
- 2.133 Rregullore për Funkionimin e Depos së MKK-së Nr. 03/2012;
- 2.134 Rregullore për Financimin e Projekteve të OJQ-ve për Zhvillimin dhe Stabilizimin e Komuniteteve Nr. 02/2012;
- 2.135 Rregullore (MKRS) Nr. 04/2017 për Përdorimin e Koleksioneve të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani";
- 2.136 Rregullore (MKRS) Nr. 14/2016 për Dhënien e Çmimit Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Muslim Mulliqi" si dhe Çmimit Vjetor për të Arriturat në fushën e Artit Pamor;
- 2.137 Rregullore (MKRS) - Nr. 09/ 2016 për dhënien e Çmimit për Veprimtari Jetësore në Fushën e Trashëgimisë Kulturore "Dea Dardanicae" dhe Çmimit Vjetor për Merita të Veçanta "Shtjefën Gjeçovi";
- 2.138 Rregullore (MKRS) Nr. 01/2016 për Punën e Këshillit Drejtues të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani";
- 2.139 Rregullore Nr. 07/2015 për Mënyrën e Funkionimit si dhe Kriteret dhe Procedurat e Ekspozimit në Galerinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- 2.140 Udhëzim Administrativ Nr. 13/2010 për Funkionimin e Depos Qendrore të MKRS;
- 2.141 Rregullore Nr. 03/2010 për Organizimin dhe Funkionimin e Brendshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- 2.142 Rregullore Nr. 12/2010 për Çmimet Vjetore në Muzikë;
- 2.143 Rregullore (MPB) Nr.03/2020 për Lartësinë e Tarifave të Shërbimeve Forenzike në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë;
- 2.144 Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 15/2016 për Mënyrën e Pranim - Dorëzimit dhe Transportimit të Dokumenteve Publike dhe Shkresave Zyrtare;
- 2.145 Rregullore (MPB) Nr. 06/2015 për Përshkrimin e Detyrave dhe Përgjegjësi të Personelit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë;

- 2.146 Rregullore (MPB) Nr. 01/2014 e Brendshme për Qasjen, Rendin, Sigurimin dhe ruajtjen e Objektivit të MPB-së;
- 2.147 Udhëzim Administrativ Nr. 14/2012 - MPB për Rrjedhjen e Informacioneve dhe Komunikimin Direkt të DHMZP-së me Agjencitë, Departamentet dhe Zyrat E MPB-së;
- 2.148 Rregullorja (MPB) Nr.10/2011 që përcakton Procedurat për Kryerjen e Inspektiveve të Komisionit në Fushën e Sigurimit të Aviacionit;
- 2.149 Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2010 - MPB për të Drejtat dhe Detyrimet e Azilkërkuesve;
- 2.150 Udhëzim Administrativ Nr. 30/2010 - MPB për Përcaktimin e Procedurës për Skanimin dhe Përshkrimin e Regjistrave të Gjendjes Civile;
- 2.151 Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2009 - MPB për Funkcionimin e Depos Qendrore të MPB-së;
- 2.152 Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2009 - MPB për Dhënien e Bursave Studentëve që Studiojnë në Fushën e Sigurisë Jashtë Vendlindit;
- 2.153 Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2013 Mbajtja e Zgjedhjeve në Universitetin "Haxhi Zeka" të Pejës;
- 2.154 Udhëzim Administrativ Nr. 11/2013 për Përcaktimin e Tarifës së Çmimeve për Shërbimet e Kontrollit të Kryera në Laboratorin e Institutit Bujqësor të Kosovës në Pejë;
- 2.155 Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr. 02/2017 për Vlefshmërinë e Programeve Studimore të Bartësve Privat të Lartë;
- 2.156 Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr. 08/2019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës;
- 2.157 Udhëzim Administrativ (MASHT) Nr. 31/2013 Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave të Shkollave të Larta Profesionale dhe Gradave Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës;
- 2.158 Udhëzim Administrativ Nr.2/2007 për Zbatimin e Planit dhe Programit të Gjuhës Shqipe për Nxënësit e Komuniteteve Joshqiptare për Klasat 3, 4, 5, 8, 9, 12, 13;
- 2.159 Udhëzim Administrativ Nr. 3/2007 për Ndarjen e Shkollave të Mesme të Ulëta nga Shkollat Filllore;
- 2.160 Udhëzim Administrativ Nr. 5/2007 për Kushtet dhe Kriteret e Themelimit, Licencimit dhe Fillimit të Punës së Institucioneve të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional;
- 2.161 Udhëzim Administrativ Nr. 6/2007 për Zgjerimin e Veprimtarisë së Shkollës Profesionale;

- 2.162 Udhëzim Administrativ Nr. 7/2007 për Sistemin e Pavarur të Ankesave dhe Procedura e Ankesës tek Vlerësimet Përfundimtare të Nxënësve dhe Vijuesve në Arsimin dhe Aftësimin Profesional;
- 2.163 Udhëzim Administrativ Nr. 9/2007 Vlerësimi Profesional i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta;
- 2.164 Udhëzim Administrativ Nr. 10/2007 Mësimi në Gjuhën e Zgjedhur Zyrtare;
- 2.165 Udhëzim Administrativ Nr. 12/2007 Organizimi i Mësimit të Klasës së Pestë;
- 2.166 Udhëzim Administrativ Nr. 14/2007 për Krijimin dhe Funkionimin e Programit për Asistencë Financiare në Universitetin e Prishtinës;
- 2.167 Udhëzim Administrativ Nr. 40/2007 për Mbikëqyrjen Profesionale Pedagogjike të Punës së Edukatoreve dhe Bashkëpunëtorëve Profesional;
- 2.168 Udhëzim Administrativ Nr. 49/2007 Zbatimi i Planit dhe Programit të Punës Edukative-Arsimore me Nxënës të Institucioneve të Arsimit Special;
- 2.169 Udhëzim Administrativ Nr. 50/2007 Zbatimi i Kurrikulës së Shkollës Shqipe të Mësimit Plotësues në Diasporë;
- 2.170 Udhëzim Administrativ Nr. 51/2007 Zbatimi i Planit dhe Programit Mësimor të Klasës së Shtatë për Shkollën e Mesme të Ulët të Muzikës;
- 2.171 Udhëzim Administrativ Nr. 52/2007 Zbatimi i Udhëzuesit si Doracak për Identifikimin, Vlerësimin dhe Arsimimin e Nxënësve që vijnë në Arsimin Special;
- 2.172 Udhëzim Administrativ Nr. 4/2006 Zbatimi i Planit dhe Programit për Klasën e Katërt;
- 2.173 Udhëzim Administrativ Nr. 5/2006 Zbatimi i Planit dhe Programit për Klasën e Trembëdhjetë;
- 2.174 Udhëzim Administrativ Nr. 6/2006 për Zbatimin e Planit dhe Programit për Klasën e Pestë;
- 2.175 Udhëzim Administrativ Nr. 7/2006 për Zbatimin e Planit dhe Programit për Klasën e Nëntë;
- 2.176 Udhëzim Administrativ Nr. 8/2006 për Masat për Përfundimin e Procesit të Rivendosjes së Qeverisjes së Ligjshme në Universitetin e Prishtinës;
- 2.177 Udhëzim Administrativ Nr. 10/2006 për Grumbullimin e Mjeteve Financiare Vetanake në Administratën e MASHT-It dhe Shfrytëzimi i tyre;
- 2.178 Udhëzim Administrativ Nr. 11/2006 për Mbajtjen e Rizgjedhjeve të Plota dhe Përmbylljen e Rivendosjes së Qeverisjes së Ligjshme në Universitetin e Prishtinës;

- 2.179 Udhëzim Administrativ Nr. 12/2006 për Zbatimin e Standardeve të Përgjithshme të Edukimit dhe Arsimit Parashkollor (3-6 Vjeç) në Kosovë;
- 2.180 Udhëzim Administrativ Nr. 13/2006 për Zbatimin e Kurrikulës për Edukim Parashkollor (3-6 Vjeç);
- 2.181 Udhëzim Administrativ Nr. 16/2006 për Zbatimin e Planit dhe Programit për Klasën e Pestë të Mësimit Joformal;
- 2.182 Udhëzim Administrativ Nr. 17/2006 për Zbatimin e Planit dhe Programit Për Klasën e Nëntë të Mësimit Joformal;
- 2.183 Udhëzim Administrativ Nr. 19/2006 për Këshillin Qendror të Shkencës;
- 2.184 Udhëzim Administrativ Nr. 20/2006 për Caktimin e Standardeve në Shkencë;
- 2.185 Udhëzim Administrativ Nr. 22/2006 për Grumbullimin e Mjeteve Financiare Vetanake në Administratën e MASHTI-t dhe Shfrytëzimin e tyre;
- 2.186 Udhëzim Administrativ Nr. 37/2006 për Zbatimin e Planit dhe Programit për Klasën e Trembëdhjetë të Lëndëve të Përgjithshme për Shkollat Profesionale;
- 2.187 Udhëzim Administrativ Nr. 7/2005 -Zbatimi i Planit dhe Programit për Klasën e Tetë;
- 2.188 Udhëzim Administrativ Nr. 8/2005 -Zbatimi i Planit dhe Programit për Klasën e Tretë;
- 2.189 Udhëzim Administrativ Nr. 9/2005 Zbatimi i Planit dhe Programit për Klasën e Dymbëdhjetë;
- 2.190 Udhëzim Administrativ Nr. 11/2005 për Procedurat Administrative të Inspektimit në Institucionet Edukativo Arsimore dhe Shkencore;
- 2.191 Udhëzim Administrativ Nr. 13/2005 - Masat Ndaj Prindërve, Fëmijët e të Cilëve nuk janë Regjistruar apo nuk vijojnë mësimin e Obliguar;
- 2.192 Udhëzim Administrativ Nr. 15/2005 për Këshillin e Ekspertëve për Plan programe dhe Tekste Shkollore;
- 2.193 Udhëzim Administrativ Nr. 17/2005 për Shkollën (Akademinë) e Administratës Arsimore;
- 2.194 Udhëzim Administrativ Nr. 19/2005 Aneksi I i Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2004 për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit (AAK);
- 2.195 Udhëzim Administrativ Nr. 22/2005- Zbatimi i Planit dhe Programit për Klasën e 12 të Lendeve të Përgjithshme për Shkollat Profesionale;

- 2.196 Udhëzim Administrativ Nr. 23/2005 për Aplikimin e Procedurave të Projektit për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim (PPPA) të Financuar nga Banka Botërore;
- 2.197 Udhëzim Administrativ Nr. 32/2005 Zbatimi i Planit dhe Programit për Arsimin Profesional Lëmi Hortikulture për Klasën e Dymbëdhjetë dhe të Trembëdhjetë;
- 2.198 Udhëzim Administrativ Nr. 37/2005 –për Rivendosjen e Qeverisjes së Ligjshme në Universitetin e Prishtinës;
- 2.199 Udhëzim Administrativ Nr. 38/2005 Zbatimi i Planit dhe Programit për Gjuhë Shqipe për Nxënësit e Komuniteteve Joshqiptare për Klasën e Tretë, Tetë dhe Dymbëdhjetë;
- 2.200 Udhëzim Administrativ Nr. 44/2005 për Themelimin e Këshillit të Eksperteve për Arsimin Parauniversitar (KEAP);
- 2.201 Udhëzim Administrativ Nr. 2/2004 për Themelimin e Këshillit të Ekspertëve për Arsimin e Lartë;
- 2.202 Udhëzim Administrativ Nr. 8/2004 Mësimi i Gjuhëve Jo Amtare;
- 2.203 Udhëzim Administrativ Nr. 11/2004 për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës;
- 2.204 Udhëzim Administrativ Nr. 13/2004 për Zbatimin e Planit dhe Programit për Klasën e Dytë;
- 2.205 Udhëzim Administrativ Nr. 14/2004 për Zbatimin e Planit dhe Programit për Klasën e Shtatë;
- 2.206 Udhëzim Administrativ Nr. 15/2004- Plotësimi dhe Ruajtja e Dokumentacionit Shkollor për Klasën e 9-të;
- 2.207 Udhëzim Administrativ Nr. 16/2004 për Regjistrimin e Nxënësve në Klasën e Parë;
- 2.208 Udhëzim Administrativ Nr. 17/2004 për Konviktet e Nxënësve dhe të Studentëve;
- 2.209 Udhëzim Administrativ Nr. 51/2004 .Zbatimi i Planit dhe Programit për Gjuhë Shqipe për Nxënësit e Komuniteteve Joshqiptare për Klasën e Gjashtë, Shtatë, Dhjetë, Njëmbëdhjetë;
- 2.210 Udhëzim Administrativ Nr. 71/2004 Mjetet Vetanake në Institucionet Arsimore;
- 2.211 Udhëzim Administrativ Nr. 09/2003 mbi Përtëritjen e Dokumentacionit Pedagogjik të Asgjësuar nga Lufta;
- 2.212 Udhëzim Administrativ Nr. 10/2003 për Qendrën e Studentëve;

- 2.213 Udhëzim Administrativ Nr. 15/2003 për Barasvlerën dhe Nostrifikimin e Diplomave të Fituara në Institucionet e Arsimit të Lartë të Kosovës;
- 2.214 Udhëzim Administrativ Nr. 16/2003 për Regjistrimin e Nxënësve në Vitin E 10-Të , Të Ardhur Nga Vendet Tjera;
- 2.215 Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2014 Për Licencimin dhe Kushtet për Ushtrimin e Veprimtarisë së Përfaqësimit në Procedurat Doganore;
- 2.216 Udhëzim Administrativ MF- Nr.02/2014 për Kornizën e Standardizuar të TI-së për Mbështetjen e Veprimeve dhe Vazhdimësinë e Shërbimeve/Sistemeve Mbështetëse dhe Rimëkëmbjen e Sistemeve të Dëmtuara në të Gjitha Sistemet e Teknologjisë Informative në Ministrinë e Financave;
- 2.217 Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2005 Pagesat Mujore për Shpenzimet e Shërbimeve Publike Komunale duke Përfshirë edhe Pagesat e Telefonisë (PTK) dhe Energjisë Elektrike (KEK);
- 2.218 Udhëzim Administrativ NJIF-K Nr. 03/2014 për Procedurat e Shqiptimit të Sanksioneve Administrative ndaj Subjekteve Raportuese që nuk janë në Pajtueshmëri me LPPPFT;
- 2.219 Rregulla Financiare mbi Pasuritë Qeveritare;
- 2.220 Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2011 për Përfundimin e Vitit Fiskal 2011;
- 2.221 Rregulla Financiare Nr. 04/2011 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore;
- 2.222 Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2010 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave;
- 2.223 Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2010 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 12/2009 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike;
- 2.224 Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2010 për Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore;
- 2.225 Udhëzimi Administrativ Nr. 17/2010 për Fillimin e Vitit Financiar 2011;
- 2.226 Udhëzimi Administrativ i Brendshëm Nr. 02/2010 për Pagimin e Shpenzimeve Postdiplomike dhe Kualifikimeve Profesionale;
- 2.227 Udhëzimi Administrativ Nr. 17/2009 Ruajtja e Integritetit të ATK-së;
- 2.228 Udhëzimi Administrativ Nr. 22/2009 Përcaktimin e Kritereve dhe Procedurën e Pajisjes me Licencë të Përkohshme të Auditorëve të Brendshëm të Sektorit Publik;
- 2.229 Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2008 për Zbatimin e Rregullore së UNMIK-ut Nr. 2005/51 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/51 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave;

- 2.230 Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2008 për Kompensimin e Pagesës së Shpenzimeve për Ushqim për Nëpunësit e Administratës Tatimore të Kosovës;
- 2.231 Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2006 për Menaxhimin e Obligimeve të Papaguara nga Viti 2005;
- 2.232 Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2006 për Zbatimin e Ligjit Nr. 2004/35 për Lojërat e Fatit;
- 2.233 Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2006 për Pagesat Mujore për Shpenzimet e Telefonisë (PTK) dhe Energjisë;
- 2.234 Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2006 për Shfrytëzimin e Telefonisë Mobile;
- 2.235 Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2006 për Mbylljen e Bankës Kreditore të Kosovës;
- 2.236 Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2006 Pagesat për Personat Individual;
- 2.237 Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2006 për Shfrytëzimin e Telefonisë Mobile Roaming;
- 2.238 Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2006 Mbi Administrimin e Ndarjes së Drejtë nëpër Komuna;
- 2.239 Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2006 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/56 dhe Rregulloren Nr. 2006/1 (të ndryshuar) mbi Taksën Shtesë në Fitimet Neto;
- 2.240 Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2006 Pagesat për Shpenzime të Rrymës Elektrike (KEK);
- 2.241 Rregulla Financiare mbi Pasuritë Qeveritare;
- 2.242 Udhëzimi Administrativ Nr. 1/2005 Ekzekutimi i Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës në të Rrjedhës Parasë së Gatshme;
- 2.243 Udhëzimi Administrativ Nr. 4/2005 mbi Tatimin në Rrugë për Automjete;
- 2.244 Udhëzimi Administrativ Nr. 7/2005 Ekzekutimi Përgjithshëm i Buxhetit të Kosovës;
- 2.245 Udhëzimi Administrativ Nr. 8/2005 Klasifikim Ekonomik i Shpenzimeve;
- 2.246 Udhëzimi Administrativ Nr. 9/2005 Pagesat për Punëtorët me Kontrata;
- 2.247 Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2005 Organizimet Financiare të Departamentit të Thesarit;

- 2.248 Udhëzimi Administrativ Nr. 2/2004 Sqarimi i Rolit të Auditorit Rajonal për Inkasim të Detyrueshëm;
- 2.249 Udhëzim Administrativ 05/2013 për Licencimin e Prodhuesve të Pajisjeve Medicinale në RKS;
- 2.250 Udhëzim Administrativ 12/2013 Vendosja e Banderolave në Produktet Medicinale;
- 2.251 Udhëzim Administrativ 13/2013 Qarkulluesit me Shumicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
- 2.252 Udhëzim Administrativ (MSH) Nr. 19/2013 Linja Telefonike për Ankesat e Qytetarëve në Ofrimin e Shërbimeve Shëndetësore;
- 2.253 Udhëzim Administrativ Nr. 3/2012 për Menaxhimin e Materialit të Inkontinencës për Persona me Aftësi të Kufizuara;
- 2.254 Udhëzim Administrativ Nr. 05/2012 Mbikëqyrja Etike Profesionale;
- 2.255 Udhëzim Administrativ Nr. 10/2011 Regjistrimi dhe Licencimi i Profesionistëve Shëndetësor;
- 2.256 Udhëzim Administrativ 06/2010 Inkurajimi, Mbrojtja dhe Përkrahja e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri, në Institucionet Shëndetësore në RKS;
- 2.257 Udhëzim Administrativ 08/2010 Vendosja e Banderolave në Produktet Medicinale;
- 2.258 Udhëzim Administrativ 09/2010 Njësive për Menaxhimin e Projektit për TB dhe HIV/AIDS në RKS;
- 2.259 Udhëzim Administrativ 07/2009 për Shërbimin Profesional të Shëndetit Mendor në RKS;
- 2.260 Udhëzim Administrativ 08/2009 Inspektorati Shëndetësor për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
- 2.261 Udhëzimi Administrativ 03/2008 Kualiteti i Kripës;
- 2.262 Udhëzim Administrativ 02/2007 mbi Masat Disiplinore dhe Gjobat Ndëshkimore për Kundërvajtje të Institucioneve Shëndetësore;
- 2.263 Udhëzim Administrativ 03/2007 Aplikimi i Rrezeve Jonizuese në Shëndetësi;
- 2.264 Udhëzim Administrativ 05/2007 Ndalimi i Pirjes së Duhanit dhe Vendosja e Shenjave të Ndalimit, Shenjëzimi i Paketimeve të Prodhimeve të Duhanit nga Prodhuesit dhe Importuesit e tij;
- 2.265 Udhëzim Administrativ 06/2007 Ndalimi i Shitjes së Prodhimeve të Duhanit Personave më të rinj se 18 Vjeç;

- 2.266 Udhëzim Administrativ 07/2007 Masat për Zvogëlimin dhe Kufizimin e Pirjes së Duhanit;
- 2.267 Udhëzimi Administrativ 08/2007 për Shërbimin Spitalor në Kosovë;
- 2.268 Udhëzim Administrativ 02/2006 Formimi dhe Funkionimi i Komisioneve për Vlerësimin e Përmbushjes së Kushteve, Teknike dhe Profesionale për Licencim të Institucioneve Private të Kujdesit Shëndetësor;
- 2.269 Udhëzim Administrativ 05/2006 për Organizimin e Inspektoratit Sanitar në RKS;
- 2.270 Udhëzim Administrativ 07/2006 Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë (Barnatoret);
- 2.271 Udhëzim Administrativ 19/2006 Disperzimi i Listës Esenciale të Barërave në Kujdesin Parësor Shëndetësor;
- 2.272 Udhëzim Administrativ 02/2005 për Mënyrën e Fitimit të Njohurive Themelore mbi Sigurinë dhe Cilësinë e Artikujve Ushqimor;
- 2.273 Udhëzim Administrativ 03/2005 Themelimi, Detyrat Dhe Përbërja e Këshillave Mbikëqyrëse të Institucioneve Shëndetësore;
- 2.274 Udhëzim Administrativ 09/2005 Standardet e Cilësisë për Licencimin dhe Akreditimin e Institucioneve Shëndetësore dhe Implementimi e tyre;
- 2.275 Udhëzim Administrativ 10/2005 për Organizimin e Institutit Kombëtar së Shëndetësisë Publike të Kosovës;
- 2.276 Udhëzim Administrativ 11/2005 për Themelimin dhe Organizimin e Departamentit Farmaceutik;
- 2.277 Udhëzim Administrativ 12/2005 për Etiketimin e Produkteve Ushqimore;
- 2.278 Udhëzim Administrativ 13/2005 për Procedurat e Miratimit të Etikës;
- 2.279 Udhëzim Administrativ 20/2004 Inspektoratit Sanitar të Kosovës;
- 2.280 Udhëzimi Administrativ Nr. 23/2004 (në Shëndetësi) Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional;
- 2.281 Udhëzim Administrativ 24/2004 Vula Zyrtare e Profesionistit Shëndetësor;
- 2.282 Udhëzim Administrativ 27/2004 Veprimtaria e Këshillit Profesional;
- 2.283 Udhëzim Administrativ 28/2004 Themelimi i Qendrës për Edukim të Vazhdueshëm Infermierik;
- 2.284 Udhëzim Administrativ 30/2004 Organizimi dhe Administrimi i Shërbimit Profesional të Shëndetit Mendor të Kosovës;

- 2.285 Udhëzim Administrativ 32/2004 për Përcaktimin e Listës së Produkteve Medicinale dhe Pajisjeve Medicinale për të cilat nevojitet Licenca për Import;
- 2.286 Udhëzim Administrativ 03/2003 Prezantimi i Regjistrimit Shëndetësor Unik në Kujdesin Primar Shëndetësor;
- 2.287 Udhëzim Administrativ 08/2003 Themelimi i Qendrës të Mjekësisë Sportive;
- 2.288 Udhëzimi Administrativ Nr. 9/2003 (Në Shëndetësi) Mbi Autorizimin e Përkohshëm të Marketingut të Produkteve Medicinale të Plasura në Kosovë;
- 2.289 Udhëzim Administrativ 11/2003 mbi Licencimin dhe Raportimin e Operimit me Prokurorë në Kosovë;
- 2.290 Udhëzim Administrativ 12/2003 Themelimi i Qendrës Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës;
- 2.291 Udhëzim Administrative 13/2003 Themelimi i Spitalit të Ferizajt;
- 2.292 Udhëzim Administrativ 14/2003 Themelimi i Spitalit në Vushtri;
- 2.293 Udhëzim Administrativ 15/2003 Pagesa e Ekspertëve Profesional dhe Komisioneve Funkzionale.
3. Obligohen ministrinë që në pajtim me fushën e përgjegjësisë së tyre administrative të iniciojnë procedurën e ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve të parapara në Analizën juridike të vlerësimit të bazës ligjore të akteve nënligjore, siç përcaktohen në Shtojcën 2.
 4. Obligohen ministrinë që varësisht nga fusha e përgjegjësisë së tyre administrative dhe në pajtim me rekomandimet e dhëna në Analizën juridike të vlerësimit të bazës ligjore të akteve nënligjore të nxjerra nga ministrat, të ndryshojnë dhe plotësojnë aktet nënligjore, siç përcaktohen në Shtojcën 3.
 5. Obligohen ministrinë përkatëse që t'i dërgojnë për publikim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe në Ueb faqet e tyre zyrtare, aktet nënligjore të cilat nuk janë të publikuara ose nuk është publikuar shfuqizimi i tyre.
 6. Obligohet Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare që të publikojë shfuqizimin e akteve nënligjore sipas pikës 1. të këtij Vendimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
 7. Obligohen ministrinë që detyrimet nga pika 3. dhe 4. e këtij Vendimi t'i përmbushin brenda një afati prej më së largu dymbëdhjetë (12) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
 8. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit që në bashkëpunim me ministrinë përkatëse të koordinojë procesin e implementimit të analizës juridike të miratuar me këtë Vendim.
 9. Pjesë e këtij Vendimi janë Shtojcat:
 - 9.1 Shtojca 1- Analiza juridike për vlerësimin e bazës ligjore të akteve nënligjore të nxjerra nga ministrat;
 - 9.2- Shtojca 2- Lista e ligjeve të cilat duhet të ndryshohen dhe plotësohen me qëllim të krijimit të bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse;

9.3- Shtojca 3- Lista e akteve nënligjore që duhet të ndryshohen dhe plotësohen me qëllim të konkretizimit të bazës ligjore.

10. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m


Sundimi i ligjit është një nga vlerat themelore të rendit kushtetutës të Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, parimi i ligjshmërisë së akteve nënligjore në kuptimin e ndalimit të veprimit arbitrar të të gjitha organeve të cilët mund të intervenojnë në marrëdhëniet ndërmjet subjekteve të së drejtës vetëm në bazë të autorizimeve të fituara me ligj, derivon edhe nga Seksioni II, A, 1, 2, , i Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit, të nxjerrë nga Komisioni i Venedikut, ku në mënyrë shprehimore përcaktohet obligimi i institucioneve për të vepruar në pajtueshmëri strikte me kompetencat e përcaktuara me ligj.

Megjithatë, në legjislacionin vendor, parimi i ligjshmërisë së akteve nënligjore (përfshirë epërsinë e ligjit në raport me aktet nënligjore, përputhshmërinë me ligjin; kompetencat ligjore të ekzekutivit si dhe detyrimi për zbatimin e ligjit) dhe parimi i sigurisë juridike (përfshirë qasjen në legjislacion, parashikueshmërinë e legjislacionit dhe pritshmërinë legjitime) është sfiduar nga nxjerra e një numri të madh të akteve nënligjore pa bazë të mirëfilltë ligjore, rregullimi me akt nënligjor i materieve që në fakt janë kategori ligjore, tejkalimi me akt nënligjor i dispozitave ligjore si dhe mungesa e evidentimit në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrive, me rastin e nxjerrjes apo shfuqizimit të akteve nënligjore.

Nisur nga këto standarde juridike ndërkombëtare të përcaktuara nga Komisioni i Venedikut në të cilin Republika e Kosovës është shtet anëtar, dhe obligimit që derivon nga pika 2.3.7 e Planit Strategjik dhe Operacional të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët të angazhuar nga GIZ, në kuadër të Projektit "Legal and Administrative Reform Project" dhe konsulencës për "Support to OPM Legal Office to implement the "guillotine" process of bylaws" dhe në koordinim me ministrinë e linjës, kanë hartuar Analizën juridike për vlerësimin e bazës ligjore të një mijë e shtatëqind e dy (1,762) akteve nënligjore të nxjerra nga ministrat.

Rekomandimet e analizës juridike në fjalë, lidhur me shfuqizimin, ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore dhe ligjeve me qëllim të krijimit të bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e akteve në fjalë, të propozuara në këtë vendim, apo në disa raste evidentimi i nxjerrjes apo shfuqizimit të akteve nënligjore, në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë, janë në funksion të plotë të sigurimit të sundimit të së drejtës, përmes sigurimit të parimit të ligjshmërisë përkatësisht sipas Seksionit II, A të Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit dhe parimit të sigurisë juridike sipas Seksionit II, B të së njëjtës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/50

Datë: 23.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Analiza juridike për thjeshtimin, bashkimin ose eliminimin e lejeve dhe licencave të lëshuara në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (pjesa e infrastrukturës).
2. Obligohen ministrinë nga pika 1. e këtij Vendimi që në pajtim me fushën e përgjegjësisë së tyre administrative të iniciojnë procedurën e ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve të parapara në Analizën juridike për thjeshtimin, bashkimin ose eliminimin e lejeve dhe licencave.
3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit që në bashkëpunim me ministrinë përkatëse të koordinojë procesin e implementimit të analizës juridike për thjeshtimin, bashkimin ose eliminimin e lejeve dhe licencave të miratuar me këtë Vendim.
4. Pjesë e këtij Vendimi është Analiza juridike për thjeshtimin, bashkimin ose eliminimin e lejeve dhe licencave të lëshuara në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (pjesa e infrastrukturës).
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/50

Datë: 23.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

